

VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

Vendimi Nr. 2023-K01

Data: 11.02.2023

Licencimi i Klubeve

Kryetari Jeton Hadërgjonaj ka marr këtë vendim në lidhje me licencimin e klubeve sipas kërkesës nga MKRS. Të gjitha klubet që nuk janë licensuar, kanë afat 90 ditë, pas datës 30.01.2023 sipas Komisionit për Licencim për të u licensuar, ose në të kundërtën do të mbesin të pa licensuara. Klubeve u kërkohet që të fillojnë procesin e grumbullimit të dokumenteve dhe dorëzimin e tyre tek Benita Selmanaj, komisionere e garave në Federatën e Tenisit të Kosovës.

Vendimi Nr. 2023-K02

Data: 11.02.2023

Suspendimi i përkrahjes financiare për tenistët për turnet individuale nga FTK-ja

Me qëllim të stabilizimit financiar të FTK-së pas vendimit të MKRS për mos pagesë të TM3 dhe TM4 me arsytim që nuk jemi licensuar para 15.12.2022, por me 30.01.2023 është marr ky vendim nga kryetari i Federatës:

Kryetari Hadërgjonaj ka marr vendim që të suspendohen deri në stabilizim financiar të FTK të gjitha mbështetjet për tenist individual për turne individuale (sipas Rregullores kemi të drejtë të e marrim këtë vendim, shikoni më poshtë).

Rregullore_Nr_03_Financa_Neni 8_pika 8.4. e cila thotë:

8.4. Për një vit kalendarik përkrahja për pjesëmarrje në turne zgjat deri në masën e paraparë me buxhetin e atij viti dhe/ose deri në masën siç e diktojnë financat e atij viti. Nëse mundësitë financiare gjatë atij viti shteren, Administrata është e obliguar t'i njoftojë prindërit, tenistët dhe tërë komunitetin për faktin që tridhjetë (30) ditë pas njoftimit nuk do të ketë më përkrahje për atë vit.

Vendimi Nr. 2023-K03

Data: 11.02.2023

Reduktimi i turneve të tenisit për secilën kategori

Kryetari Hadërgjonaj po ashtu ka marr vendim në lidhje me kufizimin e turneve në të gjitha kategoritë, pra numri i turneve të tenisit për secilën kategori do të reduktohet për ulje të shpenzimeve.

Vendimi Nr. 2023-K04

Data: 11.02.2023

Mbështetja me paisje ndaj klubeve

Kryetari Hadërgjonaj ka marr vendim që Federata nuk do t'i mbështesë me pajisje dhe topa klubet deri në vendim e rradhës.

Vendimi Nr. 2023-K05

Data: 11.02.2023

Shpërblimi për sigurimin e sponsorëve për Federatën

Sipas Rregullores së Sponsorisimit të FTK secili nga ju që e gjen një Sponsor për FTK do të shpërblehet me bruto dhjetë përqind (10%) të shumës së sponsorizuar. Pra nëse dikush na sjell një sponsor p.sh 10.000 euro ai do të merr në mënyrë krejtësisht legale 1.000 euro nga FTK. (sipas pikës në rregulloren si më poshtë)

Rregullore_Nr_03_ Neni 6_Pika 6.2 dhe 6.3 e cila thotë:

6.2. Personi që siguron sponsorizim për Federatën nga personat privatë ose korporatat (me të cilat nuk është person i lidhur), ai/ajo shpërblehet me bruto dhjetë përqind (10%) të shumës së sponsorizuar. Nga shpërblimi bruto duhet ndalur tatimin në të ardhurat personale dhe kontributet pensionale të punëdhënësit / punonjësit dhe çfarëdo ndalesash të tjera të parapara me ligjet në fuqi.

6.3. Shpërblimi i paraparë me paragrafin 6.2 do të paguhet pasi mjetet e sponsorizimit të jenë arkëtuar